



02 Nr. _____
Datë: 31.10.2024

Në bazë të kërkesës të datës 31.10.2024, me numër të protokollit: 36841/02 duke u mbështetur në nenin 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR FURNIZIM ME KARBURANTE

1. Lejohet furnizimi në sasi prej 70 L derivate për KF. Deçanin, ku do të zhvillojnë ndeshje futbolitike në Vitomericë me dt. 03.11.2024
2. Furnizimi me derivate do të bëhet në pompën e benzinës "DHF" me të cilën posedojmë kontratë për furnizim me derivate dhe paguhet nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit.
3. Për realizimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Deçan.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të kryetarit të komunës.

Me vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit
- Operatori Ekonomik
- Menaxheri i kontratës
- Arkivi KK Deçan

Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit të Komunës
Nr. 02/Zyrtarisht
Datë: 07.11.2024

Kryetari i komunës së Deçanit, në bazë nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, neni 60 të Statutit të Komunës së Deçanit, nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Kulturë, Rini dhe Sporte, me datë: 07.11.2024 mori këtë:

VE N D I M

1. Nëpunësi **Afrim HASANMETAJ**, i sistemuar në pozitën e punës: Zyrtar për Rini në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, **caktohet ushtrues detyre Udhëheqës i sektorit për Kulturë, Rini dhe Sporte**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.22 (GJ5)** duke filluar nga data **07.11.2024**.
2. I emëruari si ushtrues detyre Udhëheqës i sektorit për Kulturë, Rini dhe Sporte, kryen edhe punët si Zyrtar për Rini, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte.
3. I emëruari si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 3.1 Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së sektorit që udhëheqë;
 - 3.2 Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e sektorit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
 - 3.3 Kontribuon në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
 - 3.4 Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e sektorit si dhe aktivitetet tjera të sektorit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit.
 - 3.5 Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e sektorit.
 - 3.6 Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.
 - 3.7 Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së sektorit të cilin e udhëheqë.
 - 3.8 Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësisë organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit;
 - 3.9 Bën vlerësimin e rezultateve të punës për stafin nën mbikëqyrje të tij dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

4. Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësi: Afrim HASANMETAJ;
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të Komunës.



Bashkim RAMOSAJ

Kryetari i Komunës së Deçanit




Zyra e Kryetarit
02 Nr. _____
Datë: 26.11.2024

Në bazë të kërkesës me numër protokolli 02-38157 të datës 08.11.2024, duke u mbështetur në nenin 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR FURNIZIM ME DERIVATE

1. Lejohet furnizimi në sasi prej 150 L derivate në muajin Dhjetor, 150 L në muajin Janar dhe 150 L për muajin Shkurt, për _____ e cila vuan nga sëmundja e kancerit dhe i duhet të udhëtoj çdo ditë në Prishtinë. Furnizimi me derivate do të bëhet në makinën me targa _____, tipi VW.
2. Furnizimi me derivate do të bëhet në pompën e benzinës "Petrol Company" (DHF) me të cilën posedojmë kontratë për furnizim me derivate dhe paguhet nga linja buxhetore e Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Për realizimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës.



Me vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit
- Operatori Ekonomik
- Menaxheri i kontratës
- Arkivi KK Deçan.



Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj



Zyra e Kryetarit të komunës
Nr. 02/Zyrtarisht
Datë: 02.12.2024

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zytarët Publik dhe nenit 56, pika 20, të Statutit të komunës së Deçanit, Kryetari i komunës merr vendim për emërimin ushtrueses detyre i Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan:

VENDIM

EMËROHET USHTRUES DETYRE I DREJTORIT TË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "ADEM UKËHAXHAJ" NË DEÇAN NË KOHË TË PA CAKTUAR DERI NË PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURSIT PUBLIK PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË QKMF-SË

I

Zytari Publik-Dr. spec. i Pediatriisë: **Hasan GJIKOKAJ**, i lindur me datë: **03/09/1970**, me pozitë e pune: Specialist i Pediatriisë dhe Koordinator i ZHVP, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan emërohet ushtrues detyre i drejtorit të QKMF-së "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, qe të punoj me kompetenca të plota, në kohë të pa caktuar deri në përfundimin e procedurave të konkursit publik për përzgjedhjen e drejtorit të QKMF-së.

II

Sipas këtij vendimi punët dhe detyrat janë të përcaktuara sipas përshkrimit të vendit të punës për drejtorin e QKMF-së "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan.

III

Emërimi si ushtrues detyre, i drejtorit të QKMF-së "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan fillon nga data: 02.12.2024

IV


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesët Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

V

Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. I emëruari: Hasan GJIKOKAJ;
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan;
4. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Prishtinë dhe
5. Arkivi i komunës.



Kryetari i komunës:

Bashkim RAMOSAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN




Në bazë të kërkesës së [] nga fshati Baballoq , Komuna e Deçanit - të datës 04.09.2024 dhe numër protokolli 02-30512, për të përkrahur financiarisht dhe duke u mbështetur në nenin 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës së Deçanit, merr këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIMIN E []

- I. Lejohen mjete financiare për të subvencionuar [] nga fshati Baballoq, Komuna e Deçanit, me nr. Personal [], per trajtimin e sëmundjes se skoliozes se vajzës se tije [], per shkak te kushtev te vështira ekonomike familja nuk po mund te ja dale per te gjitha shpenzimet.
- II. Shuma e mjeteve financiare të lejuara është 1,000 (njëmijë) euro. Mjetet do të derdhen ne xhirollogarinë e [] me numër [] ne NLB Banka.
- III. Mjetet financiare si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e subvencioneve.
- IV. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.
- VI. Me vendim njoftohen :
 1. Pala;
 2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
 3. Arkivi Komunal.

02. Nr. _____
Dt. 02.12.2024



Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj

